

UDHËZIM
Nr.15, datë 8.4.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 2.2.2015 “MBI ZBATIMIN E VENDORIT NR.8, DATË 14.1.2015 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR MBROJTJEN E SHTRISAVE NË NEVOJË, NGA HEQJA E FASHËS DERI NË 300 KWH PËR FATURIMIN E ÇMIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në zbatim të pikës 6 të vendimit nr.8, datë 14.1.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 KWH në muaj” dhe në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimit ndaj kryefamiljarëve që marrin pension pleqërie ose pension invaliditeti të cilët paraqesin deklaratat dhe dokumentet për përfitimin e kompensimit të çmimit të energjisë elektrike, si dhe për të përballuar fluksin e kërkesave të pranimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit, Ministri i Energjisë dhe Industrisë, Ministri i Financave dhe Ministri i Mirëqënies Sociale dhe Rinië

UDHËZOJNË:

1.Në pikën 4 të kreut II, të udhëzimit nr.1, datë 2.2.2015, “Mbi zbatimin e vendimit nr. 8, datë 14.1.2015 të Këshillit të Ministrave për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga heqja e fashës deri në 300 kwh për faturimin e çmimit të energjisë elektrike, data 27.4.2015 bëhet 25.6.2015.

2. Germa “c” e pikës 2 të kreut I, germa “c” e pikës 1 të kreut II dhe germa “c” e pikës 1 të kreut III shfuqizohen.

3. Pas germës “d” të pikës 2 të kreut I, shtohet germa “e” me përmbajtje:
“Fotokopje e vërtetimit të KMCAP”

4. Pas paragrafit të fundit të kreut III shtohet paragrafi me përmbajtje:
“Marrëdhënia e punësimit apo vetëpunësimit të anëtarëve të familjes vërtetohet përmes deklaratimit nga përfituesi dhe në vazhdimësi do të jetë objekt i verifikimit nga institucionet në bashkëpunim me njëri-tjetrin”.

5. Ngarkohet Ministria e Financave, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.2.2015.

MINISTRI I FINANCIVE
Shkëlqim Cani

MINISTRI I ENERGJISË DHE INDUSTRIË
Damian Gjoknuri

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË
Erion Veliaj